



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 13 shkurt 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

**Në mbledhje morën pjesë:** Arben Gashi – kryetar, Arsim Bajrami, Haki Demolli, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Amir Ahmeti.

**Munguan:** Behar Selimi, Mufera Şinik, Halit Krasniqi, Ardian Gjini dhe Jasmina Zhivković.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Lumnije Murati - ZPRK, Isuf Zejna – KDI, Selman Sokolaj dhe Eroll Gashi – studentë.

**Nga stafi i Komisionit për Legjislacion:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.01.2012,
3. Kërkesa e Gjykatës Kushtetuese për lëndën KO 05/12,
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.01.2012**

**Kryetari** konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 23. 01. 2012, pa vërejtje.

### 3. Kërkesa e Gjykatës Kushtetuese për lëndën KO 05/12

**Kryetari** - I njoftoi të pranishmit me lëndën e Gjykatës Kushtetuese dhe kërkoi, që nëse kanë ndonjë qëndrim, të japin mendimin e tyre.

**Albulena Haxhiu** - Ju e keni kërkesën, që e kemi dërguar në Gjykatë dhe nuk do ta zgjas shumë. Do të përgjigjem vetëm nëse keni ndonjë pyetje eventuale.

**Arsim Bajrami** - Theksoi se këto janë procedura të rregullta para Gjykatës. Kur ajo merr një kërkesë diskuton pranueshmërinë e saj. Kjo është ende në këtë fazë, që do të thotë se sipas ligjit të Gjykatës Kushtetuese, ende nuk ka hyrë në meritum. Në këtë fazë gjykata merr opinionet edhe të propozuesit, por edhe të atij që i atakohet vendimi. Si duket nga ne, si komision, në emër të Kuvendit, është kërkuar të japim një opinion, edhe pse këto janë më tepër çështje administrative, që duhet t'i jepen Gjykatës, që merr vendim nëse kërkesa është e pranueshme. Atëherë Gjykata lëshohet në meritum. Në qoftë se Kuvendi do të jetë palë, duhet të përfaqësohet. Në situata normale do të duhej ta përfaqësonte sekretari. Prandaj, në këtë fazë, gjithçka që kërkohet nga ne si komision për të vendosur për pranueshmerinë, duhet t'ia ofrojmë në dispozicion.

**Armend Zemaj** - Kamë menduar se e kemi rastin e njëjtë, sikur me imunitetin e deputetëve, por kjo kërkesë iu ka parashtruar drejtpërsëdrejti Kryetarit të Kuvendit. Siç shihet nga shkresat edhe në aspektin juridik kërkesa po më duket e mangët, sepse në të thuhet njoftim për kërkesën dhe i drejtohet Kryetarit të Kuvendit me këto fjalë: “që duke filluar nga 31 janari 2012, nëse keni ndonjë koment lidhur me kërkesën”. Andaj unë mendoj se kërkesa iu ka dërguar drejtpërsëdrejti Kryetarit të Kuvendit, që mund të flasë në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Edhe pse adresimi i kërkesës është lënë me dy kuptime, ishte i mendimit se Kryetari i Kuvendit duhet të kthejë përgjigje ose koment lidhur me kërkesën.

**Kryetari** - Siç shihet nga shkresat nuk është kërkuar diçka konkrete. Nëse kërkohen dokumente, si transkripte, procesverbale ose dokumente të tjera, ato ia dërgon administrata e Kuvendit. Por nëse kërkohet një mendim i Komisionit, atëherë kjo duhet të bëhet në një fazë tjetër. Nëse vjen një kërkesë tjetër për të marrë mendimin e Kuvendit, për t'u deklaruar Komisioni, ne jemi të gatshëm, por për momentin kjo nuk është kërkuar.

**Amir Ahmeti** - Ishte i mendimit që kryetari i komisionit të takohet me sekretarin e Kuvendit, sepse po i drejtohet qartë Departamentit Ligjor, ose po kërkohet prej nesh ndonjë mendim. Ne mund të themi se a ka qenë konform Kushtetutës apo jo mocioni i votuar në Kuvend dhe jo t'i japim vlerësim Gjykatës Kushtetuese, sepse ata i kanë standardet e veta.

**Haki Demolli** - Duke i ndërlidhur me parafolësit tha se Gjykata Kushtetuese për ta përmbushur procedurën e vet, ka marrë nga njëra palë, në këtë rast nga Vetëvendosje, kërkesën për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së çështjes në fjalë dhe në anën tjetër kërkon nga pala tjetër, në këtë rast nga Kuvendi, mendimin për të. Në njëërën anë e ka njoftuar Kuvendin, por me të njëjtën shkresë thotë edhe “nëse keni ndonjë koment”. Për vetë faktin që thotë “nëse keni ndonjë koment” kjo nuk është obligative. Po ashtu duke pasur parasysh që edhe ky Komision është pjese e Kuvendit dhe merret me çështjet e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, normalisht, për ndonjë koment, nëse e kemi, na është drejtuar edhe neve si komision.

**Arsim Bajrami** - Siç shihet nga shkresat, është pak e paqartë çka ka kërkuar Kryesia prej neve. Gjithmonë po kemi problem me këto kërkesa, sepse nuk po janë të qarta sa duhet. Propozoi që kryetari Komisionit të takohet me Kryetarin Kuvendit dhe t'i thotë që kur të ketë kërkesa ose mocione serioze, të bëhen më të qarta, me qëllim që të dihet se çka kërkohet. Ne e kemi një shkresë që kryetari Gjykatës ia ka dërguar Kryetarit të Kuvendit, pa kurrfarë shpjegimi se çfarë kërkohet. Nëse ideja e Kryesisë ka qenë që në emër të Kuvendit të japim përgjigje, atëherë le ta kërkojnë në mënyrë institucionale.

**Kryetari** - U pajtua me parafolësin se ka nevojë për sqarime shitesë, për dy arsye: e para, nuk kemi qëndrim se çka do nga Kryetari Kuvendit dhe nga Kryesia dhe e dyta, edhe shkresa e Gjykatës është e paqartë. Unë jam dakord që të diskutohet me Kryetarin e Kuvendit, që të shihet si po e vlerëson ai atë edhe në emër të Kryesisë. Nëse na ngarkohet përgjegjësia, në rrugë formale, unë do t'jua transmetoj juve dhe bashkërisht, si komision, do të merremi vesh si të procedojmë.

*Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë*

### **Përfundim**

*Të takohet kryetari i Komisionit me Kryetarin e Kuvendit për të marrë sqarimet e nevojshme për këtë çështje.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:55

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

---

Arben Gashi